LIGJ
Nr.7579, datë 2.7.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7521, DATË 30.10.1991 "PËR PËRKRAHJEN SOCIALE PËR PERSONAT QË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 2 i ligjit ekzistues të ketë këtë përmbajtje:

Përfitojnë të drejtën e përkrahjes sociale:

a) Personat e marrë në punë me kontratë për një kohë të pacaktuar, që mbeten pa punë nga mbyllja, zvogëlimi e riorganizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve, institucioneve, organeve shtetërore, të ndërmarrjeve e shoqërive private, ndërmarrjeve e shoqërive të përbashkëta me punonjës shqiptarë, si dhe ata të partive e organizatave politike e shoqërore të njohura me ligj dhe që kanë jo më pak se 3 muaj vjetërsi pune të pandërprerë nga data e mbetjes pa punë.

b) Personat e marrë në punë për një kohë të caktuar ose përkryerjen e një pune të caktuar, që kanë humbur vendet e punës pas datës 30.6.1991 dhe që kanë jo më pak se 12 muaj vjetërsi pune të përgjithshme në ndërmarrje gjatë 3 vjetëve të fundit.

c) Ish-të dënuarit dhe të dëbuarit politikë që janë të papunë me banim në qytete, qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore, si dhe ata me banim në fshatra, familjet e të cilëve nuk kanë tokë.

ç) Ushtarakët që lirohen nga detyra para kohe, si pasojë e riorganizimit të strukturave të Forcave të Armatosura dhe që nuk përfitojnë nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

d) Ushtarët e liruar nga ushtria në vitin 1991 e këtej, që mbeten pa punë, e që para kryerjes së shërbimit ushtarak kanë qenë të punësuar, me banim në qytete, qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore dhe që ndërprerjen e punës e kanë për shkak se shkojnë ushtar.

dh) Specialistët e lartë e të mesëm, të cilët punonin në kooperativat bujqësore e që kanë dalë të papunë nga prishja e tyre dhe që në kohën e prishjes së kooperativës kanë qenë me banim në qytete, qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore, si dhe specialistët e lartë me banim në fshat.

e) Studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë me shkëputje nga puna në vitin 1990 e këtej dhe që 90 ditë pas mbarimit të shkollës mbeten pa punë.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore për personat që mbeten të papunë nga zbatimi i reformës mbështeten në pagën minimale të miratuar nga Këshilli i Ministrave, në pagën mesatare mujore të vitit të fundit të punës e në numrin e pjesëtarëve të familjes që kanë në ngarkim, dhe caktohen si vijon:

1. 50 % të pagës minimale mujore të miratuar për personat që kanë vjetërsi pune nga 3 muaj gjer në 1 vit, si dhe për personat e parashikuar në nenin 1, pikat "b" dhe "e" të këtij ligji.

2. 70 % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës për personat që kanë vjetërsi të përgjithshme pune mbi një vit.

Për këtë kategori të papunësh kufiri më i ulët i masës së përkrahjes sociale do të jetë 90 % të pagës minimale dhe kufiri më i lartë 120 % të pagës minimale.

Neni 3

Neni 4 ndahet në dy nene si vijon:

Neni 4

Për personat e papunë, familjet e të cilëve kanë tokë masa e përkrahjes sociale do të jetë:

Në zonat malore e kodrinore 10 % më e vogël se masa e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, për personat, që kanë marrë deri 1 dynym tokë për frymë; ndërsa për ata që kanë marrë mbi 1 dynym tokë për frymë 20 % më e vogël.

Në zonat fushore 25 % më e vogël, për personat, që kanë marrë deri 1 dynym tokë për frymë; ndërsa për ata që kanë marrë mbi 1 dynym tokë për frymë 40 % më e vogël.

Neni 4/a

Kur të dy mbajtësit e familjes me banim në qytete, qendra të banuara e NB mbeten të papunë, ose njëri mbetet i papunë dhe tjetri është i papunë, apo njëri mbetet pa punë dhe tjetri është në pension, për çdo person që ata kanë në ngarkim, jepet një ndihmë shoqërore në masën 20 % të pagës minimale të miratuar. Këtë ndihmë e merr vetëm njëri nga mbajtësit e familjes, kryesisht kryefamiljari.

Personave me banim në fshat që janë të paaftë fizikisht dhe që nuk kanë në familje asnjë krah të aftë për punë, u jepet ndihmë shoqërore në masën 50 % të pagës minimale.

Ndihmë shoqërore marrin në masën 60 % të pagës minimale edhe jetimët që kanë mbushur moshën e punës e janë pa punë, në qoftë se nuk marrin ndihma të tjera me akte nënligjore.

Neni 4

Në fund të nenit 7 të shtohet:

Vonesat tej këtij afati zbriten nga kohëzgjatja e përfitimit të përkrahjes sociale. Në këto raste e drejta e përfitimit të për krahjes sociale fillon nga data e paraqitjes së dokumenteve të plota.

Neni 5

Në nenin 9 të bëhet shtesa:

... dhe pasqyrohet në librezën e punës.

Neni 6

Në fund të paragrafit të parë të nenit 10 bëhet shtesa:

... si dhe kompensim veshmbathje për personat që e kanë përfituar sipas ligjit.

Neni 7

Pas paragrafit të dytë të nenit 11 shtohet:

Leja e ushtrimit të veprimtarisë private t'u jepet personave nga organi kompetent, pasi të jetë marrë vërtetimi nga zyrat e punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë. Vërtetimi të merret edhe për ata persona që u është dhënë leja para daljes së këtij ligji. Me marrjen e lejes së ushtrimit të veprimtarisë private, përkrahja sociale ndërpritet.

Neni 8

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 9

Neni 13 formulohet si vijon:

Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore caktohen mujore dhe paguhen përpjestimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që personi ka të drejtë ta marrë atë përkrahje sociale ose ndihmë.

Deri më datën 31.12.1992, pagesa e përkrahjes sociale dhe e ndihmës shoqërore bëhet:

a) pranë qendrës së punës për personat që mbeten pa punë nga zvogëlimi ose riorganizimi i qendrës së punës;

b) pranë komunave e bashkive për specialistët e mesëm dhe të lartë që kanë dalë të papunë nga prishja e kooperativave bujqësore, si dhe për personat që përfshihen në nenin 4/a, paragrafi i dytë i këtij ligji;

c) pranë zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë për:

- ish-të përndjekurit politikë sipas nenit 2 pika "c";
- ushtarakët sipas nenit 2 pika "ç";
- ushtarët e liruar nga ushtria sipas nenit 2 pika "d";
- studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë sipas nenit 2 pika "e", si dhe personat që përfshihen në paragrafin e fundit të nenit 4a;
- personat që mbeten pa punë nga mbyllja e qendrave të punës.

Pas datës 31.12.1992 pagesa e përkrahjes sociale dhe e ndihmës shoqërore do të bëhet pranë zyrave të punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë.

Neni 10

Shtohet neni 13a me këtë përmbajtje:

"Përkrahja sociale dhe ndihma shoqërore nuk tatohen".

Neni 11

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e parë fjala "ndalohet" zëvendësohet me fjalët "nuk jepet".

Në pikën "c", kur thuhet "për shkaqe të përligjura", të zëvendësohet me fjalët "pa shkaqe të përligjura".

Neni 12

Neni 16 ndryshohet si vijon:

Fondi i nevojshëm për pagesën e përkrahjes sociale e të ndihmës shoqërore krijohet nga shuma e këtyre burimeve:

a) Nga kuota prej 6% mbi fondin e pagave të realizuara çdomuaj nga veprimtaria e ndërmarrjeve, institucioneve, organeve shtetërore, ndërmarrjeve e shoqërive private dhe ndërmarrjeve e shoqërive të përbashkëta, që kanë në strukturën e tyre punonjës shqiptarë, si dhe e punëdhënësve të tjerë.

Degët e bankave në rrethe e rajone të mos bëjnë pagesën e rrogave pa u derdhur më parë kontributi i përkrahjes sociale.

b) Nga buxheti i shtetit, kur burimi sipas shkronjës "a" të këtij neni nuk mbulon pagesat e detyruara.

Neni 13

Neni 20 formulohet si vijon:

Punëdhënësit shtetërorë ose privatë kanë për detyrë të njoftojnë në zyrat e punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, për të gjitha vendet e lira të punës, brenda 10 ditëve nga krijimi i tyre.

Punëdhënësit shtetërorë a privatë kanë për detyrë të regjistrojnë në zyrat e punës, të emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, punonjësit që kanë marrë e marrin në marrëdhënie pune.

Zyrat e punës, të emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë kanë për detyrë

të mbajnë evidenca e t'i shpallin vendet e lira të punës.

Shkelja e rregullave të paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni, dënohet nga përgjegjësi i zyrës së punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, si kundërvajtje, me gjobë 5 mijë deri në 10 mijë lekë.

Kundër vendimit të përgjegjësit të zyrës së punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë bëhet ankimi te ministri i punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë brenda 15 ditëve, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 14

Në nenet ku është përdorur emërtimi "Komiteti i Punës dhe i Përkrahjes Sociale" të zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe e të Përndjekurve Politikë" dhe, atje ku është përdorur emërtimi "Zyrat e punës e të përkrahjes sociale" të zëvendësohet me emërtimin "Zyrat e punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë".

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.242, datë 7.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha